




Pranuar / Dorëzuar Prilimano/Prosato Received/Delivery	26.12.2018	8	viti god year
Organ./Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHTOK	7950/2018		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.775/2018

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga:** Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Lela Petkoviç-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.775/2018 të datës 23.11.2018 të parashtruar nga ankuesi Haxhi Bejta me adresë fshati “Prekaz i Epërm” në Komunën e Skenderajt, kundër Vendimit me Nr. 02-112/03-0058329/18 të datës 26.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt, në çështjen juridike “masë disiplinor-ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.12.2018, mori këtë:

### V E N D I M

**I. APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.775/2018 e datës 23.11.2018 e parashtruar nga ankuesi Haxhi Bejta.

**II. SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr. 02-112/03-0058329/18 i datës 26.10.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Skenderajt dhe Vendimi me Nr. 02-118/02-0054972/18 i datës 21.09.2018 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Skenderajt.

**III. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Skenderajt që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin Haxhi Bejta në vendin e tij të punës sipas Akt Emërimit të datës 27.04.2012 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e punës dhe duke bërë kompensimin e pagës nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ndaj ankuesit Haxhi Bejta, i punësuar në Komunën e Skenderajt në pozitën “Shef i Zyrës së Prokurimit”, më datë 08.02.2018 Kryetari i Komunës së Skenderajt ka njoftuar Komisionin Disiplinor për keqpërdornim e të drejtës së pushimit mjekësor dhe ka neglizhuar punës dhe detyrat zyrtare. Komisioni Disiplinor i Komunës së Skenderajt më datë 21.02.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 02/116/01-0010640/18 me të cilin ankuesit i shqiptohet masa disiplinore “vërejtje me shkrim”.

Pas vendimit të Komisionit Disiplinor të Komunës së Skenderajt, Kryetari i Komunës së Skenderajt me datë 26.02.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-116/01-0011325/18 me të cilin ka bërë pezullimin parandalues me pagesë 50% deri në 3 muaj në pagë.

Ankuesi kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor dhe kundër Vendimit të Kryetarit të Komunës së Skenderajt, më datë 08.03.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt, më datë 06.04.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-112/01-0014000/18 me të cilin ka anuluar Vendimin me Nr. 02/116/01-0010640/18 të datës 21.02.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Skenderajt duke e kthyer rastin e ankuesit në rishqyrtim tek Komisioni Disiplinor, po ashtu Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt, më datë 06.04.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-112/01-0014004/18 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e shfuqizuar Vendimin me Nr. 02-116/01-0011325/18 të Kryetarit të Komunës së Skenderajt për pezullim parandalues me pagesë 50% deri në 3 muaj në pagë.

Ankuesi Haxhi Bejta, i pa kënaqur me mos zbatimin e Vendimit me Nr. 02-112/-1-0014004/18 i datës 06.04.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Skenderajt të cilin e ka pranuar më datë 10.04.2018, me datë 07.05.2018 parashtron ankesën me numër të protokollit 2488/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 18.06.2018 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.270/2018 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit Haxhi Bejta duke e obliguar Kryetarin e Komunës së Skenderajt për zbatimin e Vendimit me Nr. 02-112/01-0014004/18 të datës 06.04.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt. Komuna e Skenderajt, më datë 04.07.2018 ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për zbatimin e vendimit të Këshillit.

Pas këtyre veprimeve Drejtori i Administratës së Komunës së Skenderajt më datë 04.09.2018, ka bërë kërkesë për zhvillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin që në bazë të raportit të hyrjedajleve z. Haxhi Bejta ka munguar në punës nga data 20.02.2018 duke kërkuar nga Komisioni Disiplinor të merr vendim në pajtim me Rregulloren për shkelje të rënda serioze. Lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore Udhëheqësi i Personelit më datë 07.09.2018 ka njoftuar edhe ankuesin.



Komisioni Disiplinor i Komunës së Skenderajt, më datë 21.09.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-118/02-0054972/18 me të cilin ankuesin i shqiptohet masa e rëndë **“ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa e dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension”**.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 02-118/02-0054972/18 të datës 21.09.2018 të Komisionit Disiplinor, më datë 10.10.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Skenderajt, më datë 26.10.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-112/03-0058329/18 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi Vendimin me Nr. 02-118/02-0054972/18 të datës 21.09.2018 të Komisionit Disiplinor.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 02-112/03-0058329/18 të datës 26.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.11.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7075/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Skenderajt më datë 27.11.2018. Komuna e Skenderajt më datë 10.12.2018 ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës, faqe 1-74.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 23.11.2018 me numër protokolli 7075/2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje ndaj njoftimit të datës 07.09.2018 të ankuesit; Njoftimin e datës 07.09.2018 nga Udhëheqësi i Personelit për ankuesin; Njoftimin datës 08.02.2018 nga Kryetari i Komunës së Skenderajt për Komisionin Disiplinor; Njoftimin e datës 12.09.2018 të ankuesin për Këshillin; Vendimin e datës 21.02.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Skenderajt; Vendimin me Nr. 02-112/03-0058329/18 të datës 26.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt; Vendimin e datës 26.02.2018 të Kryetarit të Komunës së Skenderajt për pezullimin parandalues me pagesë 50% deri në 3 muaj në pagë; Vendimin me Nr. 02-118/02-0054972/18 të datës 21.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Skenderajt; Vendimin me Nr. 02-112/01-0014000/18 të datës 06.04.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Skenderajt; Vendimin me numër A.nr.270/2018 të datës 18.06.2018 të Këshillit e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për zhvillimin e procedurës disiplinore e datës 04.09.2018; Njoftimin për fillimin e procedurës disiplinore për Komisionin Disiplinor i datës 04.09.2018; Njoftimin e datës 22.09.2018; Procesverbalin i datës 06.09.2018, 24.10.2018; Pasqyra e punëtorëve; Njoftimin për fillimin e vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 13.04.2018; Flete kthesën e datës 13.04.2018; ksen për pagesë retroaktive e datës 07.05.2018, 11.06.2018; Listën e pagave për muajin maj, qershor, korrik, gusht, shtator 2018; Njoftimin e datës 08.02.2018; Njoftimin për zbatimin e Vendimit të Këshillit i datës 02.07.2018; pasqyra e punëtorëve hyrje/dajle prej datës 13.04.2018 deri 28.05.2018; Akt Emërimin e datës 27.04.2012 të ankuesit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës datë 07.12.2016 dhe 05.12.2017.


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit Haxhi Bejta *është e bazuar, sepse*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që Komisioni Disiplinor dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Skenderajt kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi me rastin e nxjerrjes së vendimeve; Lidhur me atë që kam munguar në punë pas marrjes së vendimin të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk kam pranuar asnjë shkresë nga Komuna e Skenderajt se duhet të kthehem në vendin tim të punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar që kërkesa për zhvillimin e procedurës disiplinore e datës 04.09.2018 nga Drejtori i Administratës së Komunës së Skenderajt është iniciuar për periudhën nga data 20.02.2018, në këtë rast Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se nuk ka mund të iniciohet asnjë procedurë disiplinore për ankuesin për periudhën nga data 20.02.2018 deri më datë 18.06.2018 kur Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr Vendimin me numër A.nr.270/2018 me të cilin është aprovuar ankesa e ankuesit dhe është obliguar Komuna e Skenderajt që të kthej në vendin re tij të punës sepse duhet zbatuar Vendimi i datës 06.04.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve i Komunës së Skenderajt, rrjedhimisht Komuna e Skenderajt ka zbatuar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është përfundimtar në procedurë administrative dhe është i zbatuar për institucionin sipas Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që lidhur me atë që kam munguar në punë pas marrjes së vendimin të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk kam pranuar asnjë shkresë nga Komuna e Skenderajt se duhet të kthehem në vendin tim të punës, ka konstatuar që edhe pse Komuna e Skenderajt ka zbatuar Vendimin me numër A.nr.270/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe në bazë të listës së pagave prej muajit maj deri në muajin shtator të vitit 2018 ka marr rrogën e plotë, por që Komuna e Skenderajt me asnjë provë nuk ka dëshmuar se ka njoftuar ankuesin për zbatimin e Vendimit me numër A.nr.270/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe kthimin e tij në vendin e tij të punës, pasi që në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative parashihen format e lajmërimit të palëve, mbi këtë bazë ky pretendim është i bazuar.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që edhe nëse ankuesi do të ishte njoftuar sipas procedurave nga Komuna e Skenderajt për zbatim të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nëse nuk do të paraqitej në punë, atëherë institucion ka mund të filloj procedurën disiplinore për shkelje të rënda serioze brenda dy (2) ditëve të punës siç përcaktohet me dispozitat e nenit 12 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: ***“Nëse udhëheqësi i drejtpërdrejtë konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze, në afat prej dy 2 ditë pune do ta paraqet rastin me shkrim te udhëheqësi i njësisë së personelit”***, në këtë kuptim rasti i ankuesit është paraqitur më datë 04.09.2018, rrjedhimisht Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 02-118/02-0054972/18 të datës 21.09.2018 me të cilin ankuesi i është shqiptuar masa disiplinore ***“ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa e dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension”***, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil,



sepse nuk janë shqyrtuar faktet dhe provat që kanë të bëjnë me rastin, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Skenderajt me rastin e nxjerrjes e Vendimit me Nr. 02-112/03-0058329/18 të datës 26.10.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar vendimin e Komisionit Disiplinor i cili është nxjerr në kundërshtim me procedurën ligjore dhe ka dështuar që të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, në këtë rast pretendimi i ankuesit se Komisioni Disiplinor dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Skenderajt kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi me rastin e nxjerrjes së vendimeve, është i bazuar.

Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komuna e Skenderajt në pajtim me legjislacionin në fuqi është e obliguar që ankuesin Haxhi Bejta ta kthen në vendin e tij të punës sipas Akt Emërimit të datës 27.04.2012 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e punës dhe duke bërë kompensimin e pagës nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioje konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit Haxhi Bejta;
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Skenderajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.775/2018**

**Eshref SHABANI**

**Kryetar i Kolegjit**

**Avdyll BEKTESHI**

**Procesmbajtës**